“A nuk jua ka mundësuar Allahu edhe juve që të jepni? Kështu, çdo tesbih (subhanallah) është sadaka, çdo tekbir (Allahu ekber) është sadaka, çdo tahmid (elhamdulilah) është sadaka, çdo tehlil (la ilahe il-lallah) është sadaka, urdhri për të mirën është sadaka, ndalimi nga e keqja është sadaka dhe marrëdhënia intime (me gratë tuaja) është sadaka.”

Ebu Dherri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “Disa shokë të Profetit ﷺ i thanë atij: “O i Dërguari i Allahut, të pasurit i morën shpërblimet: ata falen ashtu siç falemi ne, agjërojnë ashtu siç agjërojmë ne dhe japin prej pasurisë që u tepron (e ne s'kemi për të dhënë). Atëherë Profeti ﷺ u tha: “A nuk jua ka mundësuar Allahu edhe juve që të jepni? Kështu, çdo tesbih (subhanallah) është sadaka, çdo tekbir (Allahu ekber) është sadaka, çdo tahmid (elhamdulilah) është sadaka, çdo tehlil (la ilahe il-lallah) është sadaka, urdhri për të mirën është sadaka, ndalimi nga e keqja është sadaka dhe marrëdhënia intime (me gratë tuaja) është sadaka.” - O i Dërguari i Allahut, a ndodh që të shpërblehemi edhe kur përmbushim epshin tonë? - thanë ata. - “Sikur dikush ta bënte në haram, a do të kishte mëkat? Rrjedhimisht, kur ta bëjë në hallall, do të ketë shpërblim”, - tha Profeti ﷺ.”

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Disa nga shokët e varfër të Profetit ﷺ u ankuan tek ai për varfërinë e tyre dhe paaftësinë për të dhënë pasuri për bamirësi, për të fituar shpërblimet e mëdha që i fitonin vëllezërit e tyre të pasur, dhe për të bërë vepra të mira si ata. Ata thanë: “Ata e falin namazin siç e falim ne, agjërojnë siç agjërojmë ne, por ata japin nga pasuria e tyre tepricën, ndërsa ne nuk kemi çfarë të japim!” Profeti ﷺ i udhëzoi ata drejt bamirësive që ata mund të bënin dhe u tha: "A nuk ju ka dhënë Allahu diçka që mund ta bëni si bamirësi për veten tuaj? Të thoni subhanallah (I Lartësuar është Allahu) është sadaka për ju. Të thoni Allahu Ekber (Allahu është më i Madhi) është sadaka. Të thoni elhamdulilah (Falënderimi i takon Allahut) është sadaka. Të thoni la ilahe il-lAllah (S’ka Zot të denjë për adhurim përveç Allahut) është sadaka. Urdhërimi për të mirën është sadaka, ndalimi nga e keqja është sadaka, madje edhe kur ndonjëri prej jush bën marrëdhënie intime me gruan e tij, është sadaka. Ata u habitën dhe thanë: "O i Dërguar i Allahut! A do të marrë ndonjëri prej nesh shpërblim për përmbushjen e epshit të tij?" Ai tha: "A nuk e shihni se, nëse ai do ta përmbushte atë në mënyrë të ndaluar, si p.sh. nëpërmjet imoralitetit etj, do të kishte mëkat? Po ashtu, kur e

përmbush në mënyrë të lejuar, ka shpërblim.

https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/4558

